

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 5

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Ftesa në dëshminë "La ilahe il-Allah"

Allahut i Madhërishëm thotë:

"Thuaj: Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I përlëvduar qoftë Allahu që nuk jam prej idhujtarëve!"¹

Ibn Abazi transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) kur e dërgoi Muadhin në Jemen, i tha:

"Ti po shkon te një popull që është pasues i Librit. Gjëja e parë në të cilën do t'i ftosh është dëshmia "La ilahe il-Allah" (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut) – në një transmetim tjetër thuhet²: "që të njësojnë Allahun". - Nëse të binden në këtë, mësoju se Allahu ua ka bërë detyrim të falin pesë namazet në ditë. Nëse do të binden për këtë, mësoju se Allahu ua ka bërë detyrim të japin zekatin, që merret nga të pasurit e tyre dhe u jepet të varfëve nga mesi i tyre. Nëse do të binden për këtë, bëj kujdes, mos merr nga pasuria e tyre e mirë. Frikësohu lutjes së të dëmtuarit, sepse ndërmjet saj dhe Allahut nuk ka pengesë!"³

Nga Sehl ibn Seadi përcillet se i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ditën e luftës së Hajberit tha:

"Nesër do t'ia jap flamurin një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë. Allahu do ta japë fitoren në duart e tij."

Njerëzit kaluan natën duke biseduar se kujt do t'i jepej flamuri. Pasi zbardhi dita, të gjithë shkuan tek i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), duke shpresuar secili që t'i jepej flamuri. Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) tha: "Ku është Ali ibn Ebi Talibi?" – "Atij i dhembin sytë." – i thanë. Pejgamberi

¹ JUSUF: 108.

² Tek Buhariu: 7372

³ Hadithi është shënuar në faqen: 15

(Paqja e Allahut qoftë mbi të!) urdhëroi që të dërgonin dikë tek ai dhe ta sillnin. Pasi e sollën, Profeti (a.s.) përshtyu në sytë e Aliut, bëri dua dhe ai u shërua sikur të mos kishte pasur asnjëherë dhimbje. Më pas, i dha flamurin duke i thënë:

"Vazhdo me kujdes, derisa të arrish në tokat e tyre. Pastaj ftoji në Islam dhe lajmëroji për detyrimet që kanë ndaj Allahut të Madhërishëm. Pasha Allahun, nëse Allahu udhëzon nëpërmjet teje edhe një njeri të vetëm, është më mirë për ty sesa devetë e kuqe."⁴

Dobitë e temës:

- Ftesa në fenë e Allahut është rruga e atyre që pasojnë të Dërguarin e Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).
- Theksimi i sinqeritetit, sepse shumë njerëz, edhe pse duket sikur thërrasin për tek e vërteta, në fakt, për shkak të mungesës së sinqeritetit, ftojnë në veten e tyre.
- Largpamësia është detyrë.
- Ndër argumentet që tregojnë të mirat e teuhidit është dëlirësia e Allahut të Lartësuar nga fyerjet.
- Nga të këqijat e shirkut është se ai konsiderohet fyerje ndaj Allahut të Madhëruar.
- Më e rëndësishmja: Qëndrimi i muslimanit larg mushrikëve (idhujtarëve), në mënyrë që të mos konsiderohet si ata, paçka se nuk bie në shirk.
- Teuhidi është detyrimi i parë.
- Në thirrje fillohet gjithmonë me teuhidin, madje edhe para namazit.
- Kuptimi i shprehjes "që të njësojnë Allahun" është i njëjtë me kuptimin e dëshmisë "La ilahe il-Allah" (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut).
- Njeriu mund të jetë prej pasuesve të Librit, por nuk e di, apo e di dhe nuk punon me të.
- Theksimi se mësimi duhet të jetë gradual.
- Fillimi me çështjet më të rëndësishme.
- Qartësimi se kujt i jepet zekati.
- I dituri ia largon dyshimet nxënësit të tij.
- Ndalimi i marrjes së pasurisë më të mirë për zekat.
- Frika nga lutja e atij që është bërë padrejtësi.
- Lajmërimi se lutja e atij që është bërë padrejtësi nuk ka pengesë.

⁴ Buhariu: 3701 dhe Muslimi: 2406.

- Nga argumentet e teuhidit janë edhe sprovat e vështirësive, urisë dhe të sëmundjeve të hasura nga zotëria i profetëve (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe zotërinjtë e njerëzve të mirë.
- Thënia e (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Do t'ia jap flamurin..." ishte një shenjë e profetësisë.
- Gjithashtu, ndër shenjat e profetësisë ishte edhe pështyma e tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në syrin e Aliut – Allahu qoftë i kënaqur me të!.
- Vlera e Aliut.
- Vlera e sahabëve, që duket në diskutimin e tyre gjatë gjithë natës dhe meraku i tyre për të marrë lajmin e fitores.
- Besimi në caktimin e Allahut, pasi arritja e marrjes së flamurit ishte pa angazhim. Ndërkaq, ata që u angazhuan për ta marrë, nuk e arritën.
- Edukata që merret nga fjala e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Vazhdo avash...!"
- Ftesa e armikut në fenë Islame para se të nisësh luftën.
- Lejueshmëria e ftesës në Islam edhe për ata që janë ftuar dhe janë luftuar më parë.
- Ftesa me urtësi, nisur nga fjala: "...dhe lajmëroi për detyrimet që kanë...!"
- Njohja e të drejtës së Allahut të Lartësuar në fenë Islame.
- Shpërblimi i atij që udhëzon në rrugë të drejtë qoftë edhe një person të vetëm.
- Betimi gjatë dhënies së fetvasë.

Ky kapitull është: "Ftesa në dëshminë: "La ilahe il-Allah"; domethënë kapitulli i ftesës në teuhid. Para këtij ishte kapitulli "Frika nga shirku" dhe para tij ishte "Vlera e teuhidit dhe çfarë gjynahesh fshin" dhe "Kush realizon teuhidin, hyn në Xhenet pa dhënë llogari". Me kapitullin "Frika nga rënia në shirk", autori përmbledh karakteristikat e teuhidit të vërtetë për shpirtin e monoteistit. Ai që e ka në zemër teuhidin e vërtetë, ia njeh vlerën dhe kuptimin e tij, frikësohet nga shirku, qëndron i palëkundur në teuhid dhe largohet nga të kundërtat e tij - a mund të mjaftohet vetëm me vetveten, duke privuar të tjerët prej teuhidit? A mund të përmbushet teuhidi i vërtetë në zemër, pa i ftuar të tjerët në të drejtën më të madhe të Allahut, që është njësimi i Tij në adhurim dhe në cilësitë dhe atributet e Tij? Sigurisht që jo!

Shejhu e nis kapitullin me këtë temë, për të treguar se frika e vërtetë nga shirku dhe teuhidi i plotë janë vetëm atëherë kur njeriu i fton edhe të tjerët në teuhid. Ky është realiteti i dëshmisë "La ilahe il-Allah". Të dëshmosh "La ilahe il-Allah" domethënë: ta besosh, ta shqiptosh dhe t'u tregosh të tjerëve çfarë do të thotë

ajo. Kështu, në përmbushje të teuhidit, duhet që muslimani monoteist i përgjegjshëm t'i ftojë edhe të tjerët në të teuhid.

Gjithashtu, është edhe një urtësi tjetër: Pas këtij kapitulli vjen komentimi i teuhidit, sqarimi i elementëve të tij, si edhe shpjegimi i shirkut dhe i elementëve të tij, në mënyrë që ftesa në dëshminë "La ilahe il-Allah" dhe në teuhid të jetë e detajuar. Kjo është shumë e rëndësishme, se shumë prej atyre që pretendojnë se kanë dituri, janë dakord me teuhidin në përgjithësi, por kur vjen puna tek detajet e tij apo detajet e shirkut kanë qëndrimet të ndryshme.

Ajo që e dallon ftesën e imami reformator (Allahu e mëshiroftë!) është fakti se ftesa në dëshminë "La ilahe il-Allah" është e detajuar dhe jo e përgjithshme. Në mënyrë të përgjithshme ftojnë shumë nga ata që thonë: "Ne i kushtojmë kujdes teuhidit dhe distancohemi nga shirku", por ata nuk bëjnë shtjellime. Imami (Allahu e mëshiroftë!) në disa korrespondenca të tij thotë se, kur ia paraqiti ftesën për në teuhid dijetarëve të vendeve të ndryshme, ata - citojmë: "Ranë dakord me mua, përveç në dy çështje: në çështjen e tekfirit (të gjykimit se kur një person nuk konsiderohet më një musliman) dhe në çështjen e luftimit."⁵ Këto dy çështje u bënë shkak që dijetarët të kundërshtonin Shejhun, sepse janë dy çështje që lidhen me detajet e teuhidit dhe të shirkut.

Atëherë, ftesa për në dëshminë "La ilahe il-Allah" është ftesë në treguesit teuhidit, të mohimit të shirkut në adhurim, në *rububije*, në emrat dhe cilësitë e Allahut të Lartësuar. Kjo ftesë bëhet e detajuar, jo në mënyrë të përgjithshme. Kjo është arsyeja që Imami (Allahu e mëshiroftë!) shpjegon në këtë libër llojet e teuhidit, elementët e teuhidit në adhurim, shirkun e madh dhe të vogël dhe degët e tyre. Komentimi i dëshmisë "La ilahe il-Allah" do vijë në kapitullin pasardhës "Shpjegimi i teuhidit dhe i dëshmisë La ilahe il-Allah".

Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) thotë se Allahu i Madhërishëm ka thënë:

"Thuaj: "Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I përlëvdUAR qoftë Allahu, që unë nuk jam prej idhujtarëve!"⁶

Ky është nga ajetet e fundit të sures Jusuf, që fton për tek Allahu i Madhërishëm, madje, për atë që mediton, e gjithë surja Jusuf është ftuese për tek Allahu, nga fillimi deri në fund. Tematika e saj është daveti (ftesa) për tek Allahu i Lartësuar.

⁵ Shiko: 'Risail shekthsije' e imam Muhamed ibn Abdul Uhabi, faqja: 25.

⁶ JUSUF: 108.

Kjo është arsyeja që në fund të kësaj sureje ka rregulla të rëndësishme, që qartësojnë gjendjen e ftuesve për tek Allahu, siç ishin të Dërguarit e Tij. Aty qartësohet fakti se shumica e njerëzve i kundërshtoi ata, aq sa edhe të dërguarit i humbën shpresat tek ata. Në fund të kësaj sureje, Allahu thotë:

"Thuaj: "Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë."⁷

Domethënë, rruga që kam zgjedhur është të ftoj për tek Allahu i Lartësuar. Detyra e profetëve është ftesa për në rrugën e Allahut. Fjalët më të mira janë të atij që fton për tek Allahu, vepra më e mirë është e atij që fton për tek Allahu i Madhërishëm, i cili thotë:

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: "Unë jam vërtet mysliman."⁸

Hasan Basri⁹ (Allahu e mëshiroftë!), për komentimin e këtij ajeti, me fjalë të tjera thotë: "Ky është i dashuri i Allahut. Ky është i afërmi i Allahut. Ky është i zgjedhuri i Allahut. Iu përgjigj ftesës së Allahut dhe i ftoi njerëzit në ftesën e Tij."¹⁰

Kjo është çështje madhore. Ftuesi për tek Allahu është më fjalëmiri, siç tregon ajeti i lartpërmendur. Pjesa argumentuese nga ajeti: "Thuaj: "Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut" është thënia: "ftoj drejt Allahut", pra, ai fton për tek Allahu dhe tek askush tjetër. Këtu nxjerrim dy mësimë:

1. Ftesa për tek Allahu është ftesa për në teuhid, për në fenë e Tij, ashtu siç do ta shikojmë në komentimin e kësaj fjale, në dy hadithet më pas: në hadithin e dërgimit të Muadhrit në Jemen dhe në hadithin e Sehl ibn Sead në dhënien e flamurit Aliut.¹¹
2. Theksimi i sinqeritetit. Sinqeriteti është i domosdoshëm për cilindo që fton në dëshminë "La ilahe il-Allah" dhe në fenë islame. Ftuesi në fenë Islame e ka të nevojshme të jetë i sinqertë. Për këtë Shejhu, në këtë kapitull, pas thënies së Allahut "drejt Allahut"¹², cek rëndësinë e sinqeritetit, pasi shumica e njerëzve,

⁷ JUSUF: 108.

⁸ FUSSILET: 33.

⁹ Hasan Ibn Ebi Husen el-Basriu, imam i devotshëm, Ebu Seid dhe emir i babait: Jesar, zotëri prej tabi'inëve, me dije dhe vepra, i sinqertë dhe i devotshëm. Ndërroi jetë në vitin: 110h. Shiko: "Bidajetu ue nihajetu": 9/266, dhe "Shudhurat dheheb", 1/136.

¹⁰ Abdu Rrazak në komentimin e tij: 2/187

¹¹ U përmend transmetimi i dy haditheve në faqen: 66.

¹² JUSUF: 108.

edhe nëse duket se ftojnë për tek e vërteta, në fakt, ftojnë tek vetvetja e tyre.¹³

"...me dituri të plotë", domethënë me dije. Dija për zemrën është si drita për syrin, sepse nëpërmjet saj sheh të dhënat dhe faktet, ashtu si me anë të dritës shikon objektet dhe materien. Qëllimi është se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ftoi me dije, me bindje, me njohuri dhe nuk ftoi për tek Allahu me injorancë.

Thënia e Allahut të Madhërishëm: "...unë dhe çdokush që më pason mua."¹⁴
Domethënë: Unë ftoj për tek Allahu, e po ashtu ndjekësit e mi. Pra, edhe ata që i janë përgjigjur ftesës sime, ftojnë drejt Allahut me dije të plotë. Kjo përshtatet me ajetin kuranor më lart, pasi tregon se edhe ndjekësit e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ftonin gjithashtu për tek Allahu.

Pasuesit e të Dërguarit të Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), njësuësit e Allahut, domosdoshërisht duhet të jenë ftues për tek Allahu. Madje, kjo është karakteristikë e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe e pasuesve të tij, që Allahu urdhëroi që të shpalojë. Allahu i Madhërishëm thotë:

"Thuaj (o Muhamed): "Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua."

Kjo është veçoria e pasuesve të profetëve, të cilët jo vetëm iu frikësuan shirkut dhe njohën teuhidin dhe punuan me të, por ftuan edhe të tjerët në këto gjëra. Kjo çështje është e paevitueshme: kush e njeh të drejtën madhore të Allahut të Lartësuar, ai është xheloz për këtë të drejtë. E si mund të mos xhelozojë ndaj Zotit të tij, ndaj të drejtës së Atij që e do mbi çdo të dashur. Si mundet ai, kur sheh njerëzit që i dedikohen dikujt tjetër, të mos ftojë për në bazat e fesë së të gjithë profetëve, që është njësimi i Allahut të Lartësuar në adhurim, në *rububije* dhe në emrat e cilësitë e Tij të larta.

Shejhu pastaj cek hadithin e Ibn Abazit se, i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur e dërgoi Muadhin në Jemen, i tha:

"Ti po shkon tek një popull që është pasues i Librit. Gjëja e parë në të cilën do t'i ftosh është dëshmia "La ilahe il-Allah" (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut" – në një transmetim tjetër¹⁵: "që të njësojnë Allahun".

¹³ Shiko: Faqja: 63.

¹⁴ JUSUF: 108.

¹⁵ Buhariu: 7372

Pjesa argumentuese është se Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e urdhëroi Muadhin që gjëja e parë në davet të ishte dëshmia “La ilahe il-Allah”, të cilën e shpjegon një transmetim tjetër tek Buhariu, në Kapitullin e teuhidit, fjala: “...që të njësojnë Allahun”.¹⁶

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e urdhëroi Muadhin që të ftonte në Islam banorët e Jemenit, të cilët ishin pasues të Librit dhe adhurimet i kryenin sipas mësimëve të Teuratit dhe Ungjillit, pasi disa ishin hebrenj e disa të krishterë, kurse idhujtarë kishte pak. Shumica bënë pjesë në një rën nga këto dy besime. Dijetarët thonë se thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) **"Ti po shkon tek një popull që janë pasues të Librit"** tregon se ai po e mobilizonte moralisht, që të ishte gati për të debatuar me banorët e Jemenit. Muadh Ibn Xhebeli ishte prej dijetarëve të fesë Islame, pra ndër më të diturit e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë).

Analiza gramatikore e fjalisë: "Gjëja e parë në të cilën do t'i ftosh është dëshmia "La ilahe il-Allah"

Fjala “euel” (e para) me zanoren “l” pas *lamit* është emër i foljes “jekun” (të jetë) dhe me zanoren “e” thënia “shehadete” (dëshmia), e cila në këtë rast është kallëzorja e foljes “jekun” (të jetë). Kuptimi është tregimi i rendit të gjërave e jo renditja sipas rëndësisë.

Së dyti, fjala “euel” (e para) me ‘e’ është kallëzorja e foljes “jekun” (të jetë), ndërsa fjala “shehadetu” (dëshmia) merr zanoren “u”, që në këtë rast është emër i ardhur pas foljes “jekun” (të jetë). Kuptimi është: Bërja me dije se dëshmia që është gjëja e parë dhe më e rëndësishmja me të cilën fillon ftesa në Islam. Të dyja format janë të lejueshme.

Më e njohura është forma e dytë, pra me ‘e’, “euel”, sepse pozita e dëshmisë është më e larta dhe fillimi me të është më i rëndësishëm. Ky është qëllimi: tërheqja vëmendjes së dëgjuesit dhe bashkëbiseduesit, që në këtë rast është Muadhi, se çfarë t’ua mësonte të tjerëve pikë së pari.

Pjesa argumentuese nga hadithit dhe përshtatshmëria në këtë kapitull është përmendja se teuhidi (dëshmia: “La ilahe il-Allah”) është gjëja e parë me të cilën fillon daveti.

¹⁶ Transmetimi është përmendur në faqen: 66.

Pastaj përmendet hadithi i Sehl ibn Seadit, i cili ndodhet në të dy librat e saktë të hadithit e që thotë se i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ditën e luftës së Hajberit tha:

"Nesër do t'ia jap flamurin një burri që do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë. Allahu do ta japë fitoren në duart e tij." Njerëzit kaluan natën duke biseduar se kujt do t'i jepej flamuri.

Kuptimi i fjalës "jedukune lejletehum" është: u futën thellë në mendime. "Batu" domethënë vazhduan bisedën gjithë natën, pa fjetur, për shkak të mirësisë së madhe të përmendur nga Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

"Pasi zbardhi dita të gjithë shkuan tek i Dërguari i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), duke shpresuar secili që t'i jepej atij flamuri. Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) tha: "Ku është Ali Ibn Ebi Talib?" I thanë: "Kishte dhimbje të syve." Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) urdhëroi që të dërgonin dikë tek ai dhe ta sillnin. Pasi e sollën, Profeti (a.s.) përshtyu në sytë e Aliut, bëri dua dhe ai u shërua, sikur të mos kishte pasur asnjëherë dhimbje. Më pas, Profeti (a.s.) i dha flamurin Aliut, duke i thënë:

"Vazhdo ngadalë, derisa të arrish në tokat e tyre. Pastaj ftoji në Islam!"

"Vazhdo ngadalë, derisa të arrish në tokat e tyre. Pastaj ftoji në Islam!" është pjesa argumentuese dhe përshtatshmëria e hadithit në këtë kapitull.

"Pastaj ftoji në Islam dhe lajmëroi për detyrimet që kanë ndaj Allahut të Madhërishëm". Ftesa në fenë Islame është ftesa për në teuhid, pasi shtylla më madhështore e fesë Islame është dëshmia "La ilahe il-Allah, ue enne Muhammeden resulullah" (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij).

Më pas, i Dërguari (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), krahas shehadetit, e orientoi Aliun t'u tregonte njerëzve për të drejtat e Allahut mbi ata:

"Dhe lajmëroi për detyrimet që kanë ndaj Allahut të Madhërishëm...", domethënë tregoi se ç'të drejtash ka Allahu në Islam, në aspektin e teuhidit, të detyrimeve dhe të largimit prej të ndaluara.

Nisur nga kjo, themi se është detyrë që ftesa të fillojë me bazën e fesë Islame, që është teuhidi, me sqarimin e kuptimit të dy dëshmimeve, pastaj me shpjegimin e ndalesave dhe të detyrimeve fetare.

Ajo që vërehet këtu është se ajeti i sures Jusuf na mëson se të gjithë sahabët ishin ftues për tek Allahu i Lartësuar dhe për në teuhid. Hadithi Muadhit qartëson se Muadhi ishte nga ftuesit për tek Allahu, madje sqaron edhe llojin e ftesës. Gjithashtu edhe hadithi i Sehl Ibn Seadit, i cili përmend historinë e Aliut dhe ftesën për në fenë Islame. Këto dy hadithe janë komentues të thënies së Allahut të Madhërishëm:

“Thuaj: “Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua.”¹⁷

Ftesa me dije të plotë është ftesa për në dëshminë "La ilahe il-Allah," domethënë për në teuhid dhe në fenë Islame, me qartësimin e detyrave të robërve ndaj Allahut të Lartësuar.

¹⁷ JUSUF: 108.